



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

Tiranë, më 25.09.2022

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

➤ SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ Detyrat kryesore:

1. Përgatit raporte 3 mujore, 6 mujore, 9 mujore dhe vjetore të cilat lidhen me aktivitetin e sektorit të burimeve njerëzore.
2. Plotëson dhe kujdeset për mirëmbajtjen e dosjeve të personelit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Administron regjistrin qendror HRMIS duke përditësuar informacionin për çdo punonjës.
4. Asiston në organizimin e trajnimeve të ndryshme për stafin e ri.
5. Asiston në procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve çdo gjashtë muaj

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Shoqërore. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.

5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 27.09.2022, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL